

**V E N D I M**  
**Nr.431, datë 11.6.2001**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.358, DATË 28.7.1999 TË KËSHILLIT TË**  
**MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS SË PAGËS SË PUNONJËSVE TË**  
**DOGANAVE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2 dhe 6 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës” dhe të ligjit nr.8449, datë 27.1.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Kryeministrit, Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

Në vendimin nr.358, datë 28.7.1999 të Këshillit të Ministrave të bëhen këto ndryshime:

1. Në fund të pikës “I” shkronja “a”, paga e “Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave” bëhet 61 301 lekë në muaj dhe në shkronjën “b”, paga e “Zëvendësdrejtorit të Përgjithshëm të Doganave” bëhet 43 778 lekë në muaj.

2. Lidhja nr.1 “Struktura e pagës së doganave” dhe lidhja nr.2 zëvendësohen me lidhjet me të njëjtin numër, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

3. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi të përballohen nga buxheti i vitit 2001, miratuar për Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1.7.2001.

**KRYEMINISTRI**  
**Ilir Meta**

**LIDHJA NR.1**  
**STRUKTURA E PAGËS SË DOGANAVE**

| K<br>A<br>T<br>E<br>G<br>O<br>R<br>I<br>A | EMËRTIMI                                                                           | PAGA MUJORE        |                          |                            |                             |
|-------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------|--------------------|--------------------------|----------------------------|-----------------------------|
|                                           |                                                                                    | PAGA INDIVIDUALE   |                          | SHITESA E PROFESIONIT      |                             |
|                                           |                                                                                    | Paga e grupit (PG) | Shtesa për vjetërsi në % | Shtesa për kualifikim në % | Shtesa për pozicion në lekë |
|                                           | A.. Drejtor drejtorie në Departament<br>Drejtor Drejtorie Rajonal                  | 1                  | 2% e PG për çdo vit pune |                            | 24 739                      |
|                                           | B. Përgjegjës sektori<br>Kryetar dege<br>Inspektor                                 | 1                  | 2% e PG për çdo vit pune |                            | 19 606                      |
|                                           | C1.Specialist, Hetues dogane<br>Drejtues turni                                     | 1                  | 2% e PG për çdo vit pune |                            | 12 373                      |
|                                           | C2. Doganier                                                                       | 1                  | 2% e PG për çdo vit pune |                            | 9 747                       |
|                                           | C2. Doganier                                                                       | 3                  |                          |                            | 9 747                       |
|                                           | D1. Doganier, shofer, regjistruar,<br>sekretare, magazinier, operator,<br>laborant | 3                  | 2% e PG për çdo vit pune |                            | 7 948                       |
|                                           | D2. Centralist, sportelist                                                         | 3                  | 2% e PG për çdo vit pune |                            | 7 948                       |
|                                           | Sanitare, punëtor mirëmbajtjeje                                                    | 4                  | 2% e PG                  |                            | 4 565                       |

|  |  |                     |  |  |  |
|--|--|---------------------|--|--|--|
|  |  | për çdo vit<br>punë |  |  |  |
|--|--|---------------------|--|--|--|

LIDHJA NR.2

| Grupi | Paga në lekë |
|-------|--------------|
| 1.    | 9 000        |
| 2.    | 8 000        |
| 3.    | 6 000        |
| 4.    | 3 600        |